

**BASHA NË DIBËR:
PERFUNDONJME..
RRUGEN E ARBËRIT
DHE RIHAPIM
UNIVERSITETIN**



**KRYETARI I PD NË BULQIZË:
STATUSI I MINATOREVE DO
TE JETE REALITET BREND
6 MUAJVE TE PARE TE
QEVERISJES**

SI TË VOTONI PËR KANDIDATIN EDMOND ISAKU NË QARKUN DIBËR

1. Vendosni **X** te kutiza e numrit 9 në listën e partive, numër i cili i korrespondon Partisë Demokratike dhe vendosni **X** në kutizën e numrit 4 tek lista e kandidatëve, numër i cili i përket kandidatit **EDMOND ISAKU** për PD në Qarkun DIBËR.

2. Nëse nuk dëshironi të votoni për partinë Demokratike, por preferenca juaj është kandidati **EDMOND ISAKU**, ju lutem vendosni **X** vetëm në kutizën e numrit 4 tek lista e kandidatëve të partisë Demokratike në Qarkun Dibër.



SHANSI për të ndryshuar jetën tuaj ka numrin 4!

Votoni EDMOND ISAKUN

Deputeti që ju dëgjon, ju respekton dhe ju mbron!

VOTO Nr. 4



EDMOND ISAKU



KUJDES!

VOTË E VLEFSHME:

1. Vota për një parti dhe një kandidat brenda të njëjtës parti.
2. Vota vetëm për një parti dhe pa votuar kandidatin.
3. Votë vetëm për një kandidat të preferuar por pa votuar asnjë parti.

VOTË E PA VLEFSHME:

1. Kur votoni një parti politike dhe kandidatin e një partie tjetër.
2. Kur votoni një numër kandidati dhe vendosni shenja prishëse në pjesën tjetër të fletës së votimit.
3. Kur zhgarravisni fletën ose kryeni shënime që ndikojnë në palexueshmërinë e votës.
4. Kur votoni më shumë se një parti ose më shumë se një kandidat.



DIBËR/ BASHA PRITET ME ENTUZIAZËM: RAMA E KTHEU NË ÇIFLIG, NE DO TA SHËROJMË. DO TA RIKTHEJMË UNIVERSITETIN

speciale

25 prilli është dhe duhet të jetë një ditë çlirimi dyfish për Dibrën

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha është pritur me entuziazëm të jashtëzakonshëm në Dibër, të shtunën më 10 prill 2021, ku theksoi se ka ardhur koha për ti dhënë fund dimrit 8 vjecar.

Basha është pritur me entuziazëm nga mijëra qytetarë të cilët kishin dalë në shesh me flamujt kombëtar e të PD-së në duar. Po ashtu nuk kanë munguar as brohoritjet me thirrjet 'Rama ikl', 'E gjithë Dibra është me ty'.

Në fjalën e tij kreu i opozitës është zotuar për të rikthyer aty filialin e universitetit, të cilin ua mbylli qeveria "Rama". Po ashtu ai ka thënë se pas 25 prillit nëse do të jetë në krye të qeverisë programet e trajnimit dhe punësimit për të rinjtë, do të vihen në zbatim.

"Të bësh një gabim është realitet i jetesë por qartësisht me fuqizimin dhe rifuqizimin e këtyre individëve është e qartë që nuk bëhet fjalë për një gabim, bëhet fjalë për një vendim të kryeministrit në ikje i cili në kurriz të dibranëve, madje do të thosha edhe në kurriz të socialistëve të ndershëm dibran ka ngritur një sekt me qëllimin e vetëm për të grabitur pasuritë e kësaj zone, për të nëpërkëmbur banorët e kësaj zone dhe për ta kthyer atë në një çiflig të tekave të tij personale.

Ndaj, 25 prilli është dhe duhet të jetë një ditë çlirimi dyfish për Dibrën. Çlirim nga një stres, nga një akth, nga një



makth i pushtimit të gjithë hapësirës institucionale, vendore, qendrore, publike, ekonomike nga një bandë që nuk e lidh asgjë me vlerat, virtytet, ëndrrat, ambiciet e familjeve dibrane për fëmijët e tyre dhe nga ana tjetër bashkimi për një program, me një ekip i cili synim kryesor ka që këto pasuri magjepsëse të Dibrës dhe virtytet për të cilat Dibra njihet në të gjithë vendin, ato të punës, të mençurisë, të mirëadministrimit të kthehen në mirëqenie për Dibrën dhe

dibranët.

Kostoja e arsimit të fëmijëve dibranë është shtuar, ndërkohë që është shkullur padrejtësisht ajo që duhet të ishte një vatrë jo vetëm për trevën e Dibrës por për të gjithë Shqipërinë verilindore.

Dhe jo më kot në programin tonë ne kemi vendosur arsimin e lartë si një prioritet absolut dhe hapjen e rihapjen e institucioneve të arsimit të lartë me fokus të veçantë tek trajnimi profesionalë i rinisë..

• **BASHA: "25 prilli është dhe duhet të jetë një ditë çlirimi dyfish për Dibrën. Çlirim nga një stres, nga një akth, nga një makth i pushtimit të gjithë hapësirës institucionale, vendore, qendrore, publike, ekonomike nga një bandë që nuk e lidh asgjë me vlerat, virtytet, ëndrrat, ambiciet e familjeve dibrane për fëmijët e tyre dhe nga ana tjetër bashkimi për një program, me një ekip i cili synim kryesor ka që këto pasuri magjepsëse të Dibrës dhe virtytet për të cilat Dibra njihet në të gjithë vendin, ato të punës, të mençurisë, të mirëadministrimit të kthehen në mirëqenie për Dibrën dhe dibranët"**

Dy nga vendimet e para që do të marrë qeveria e ardhshme do të jenë hapja e universitetit të Dibrës dhe përfundimi i Rrugës së Arbërit

Basha me intelektualët dibranë: Përfundojmë Rrugën e Arbërit dhe rihapim Universitetin

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, në vizitën e tij në Dibër gjatë turit elektoral (të shtunën e 10 Prillit 2021), ka zhvilluar një takim me intelektualë të këtij qyteti.

Ata i shprehën Bashës problematikat që përbalen sot, ku kanë veçuar emigracionin si një fenomen negativ për rininë e Peshkopisë dhe mbylljen e universitetit që ka penalizuar shumë studentë.

"Dibrës nuk i kanë munguar asnjëherë intelektualët, por sot janë rralluar, një pjesë dolën në pension si puna ime. Një pjesë që kanë qenë cilësor, kanë ikur nga Amerika, nga Londra, nga Gjermania, Italia. Megjithatë popullsia rigjenerohet dhe nxjerr rini. Universiteti i Dibrës duhet të hapet, sepse Dibra pa patur një universitet i kanë pas thënë universiteti i Dibrës, pa patur universitet, jo më ta kesh dhe ta mbyllësh. Është injorancë të mbyllet universiteti. Ky universitet ka qenë jo vetëm për Dibrën, por edhe për të gjithë rajonin e më gjerë. Nuk ka qark pa universitet. Unë jam me profesion mësues dhe e ndjej shumë këtë, edhe se ish nxënësit e mi kanë ikur, edhe fëmijët e mi kanë ikur, edhe e kemi shumë problem social këtë", u shpreh Hajri Begu, mësues e drejtor shkolle i talentuar në pension.

"Shqetësimi im më i madh është braktisja e Dibrës nga të rinjtë. Ky shqetësim është për të gjithë Shqipërinë, por veçanërisht për Dibrën nuk e ekgjergjoj aspak kur them se është një plagë e rëndë. Është shumë e rëndë për një nënë, për një prind kur e shikon që fëmijët i ikin çdo ditë rrugëve të botës pa shpresë, pa punë. Është shumë e rëndë për një dibrane dhe për një dibran kur shikon rrugët e qytetit të boshatisura dhe që vazhdojnë të boshatisen. As

qeveria vendore as qeveria qendrore deri më sot në këto 8 vite nuk ka bërë asnjë politikë punësimi për të rinjtë dibranë. Pra për të rinjtë e vendit por veçanërisht dibranë. Jo vetëm të rinjtë por të gjithë dibranët i kanë sytë tek ju. Ata shpresojnë që ju ti riktheni fëmijët, t'u riktheni mirëqenien, t'u riktheni shpresën", u shpreh mësuesja Esiel Çuku.

Duke e cilësuar si një qytet të punës, dijes dhe mençurisë, Basha tha se Dibra për 8 vite ka patur plagën më të madhe të dështimit qeveritar. Sipas tij, kjo gjë do marrë fund me ndryshimin më 25 Prill dhe me programin e Partisë Demokratike, i cili parashikon mbështetje për të rinjtë, fermerët dhe arsimin. Ai gjithashtu u zotua se dy nga vendimet e para që do të marrë qeveria e ardhshme do të jenë hapja e universitetit të Dibrës dhe përfundimi i Rrugës së Arbërit.

"Është kënaqësi e jashtëzakonshme të ndodhem prapë në mesin tuaj, Dibrës së mençurisë, punës, dijes, dhe të qëndresës. Sigurisht që është një kohë e vështirë për të gjithë Shqipërinë dhe për Dibrën, por është dhe një kohë vendimesh të mëdha. Dibra dhe dibranët kanë ditur të marrin përsipër përgjegjësitë mbi shpatullat e tyre jo vetëm për këtë trevë por për të gjithë Shqipërinë në momente të këtilla të vështira dhe në momente vendimtare siç është 25 prilli. Kanë ditur të bashkohen për të bërë zgjedhjet e duhura, zgjedhjet e mençura për veten e tyre, për familjet e tyre, për Dibrën dhe për mbarë kombin. 25 prilli po afron dhe ku më shumë se në Dibër ka dhembur plaga e këtyre 8 viteve ku njerëzit e kanë ndjerë deri në palcë dështimin 8 vjeçar, rënien dramatike të ekonomisë, diskriminimin, ndarjen e njerëzve në të nënës dhe në të njerëz, ku në fakt shumica dërrmuese janë varfëruar, janë shpunësuar, janë nëpërkëmbur. Ndërkohë pushteti politik, pushteti ekonomik,

pushteti administrativ jo vetëm është përqendruar në një grup njerëzish, por është përqendruar tek disa individ që nuk përfaqësojnë Dibrën, nuk përfaqësojnë vlerat e kësaj treve. Përkundrazi përfaqësojnë më të keqen e më të keqes. Të bësh një gabim është realitet i jetesë por qartësisht me fuqizimin dhe rifuqizimin e këtyre individëve është e qartë që nuk bëhet fjalë për një gabim, bëhet fjalë për një vendim të kryeministrit në ikje i cili në kurriz të dibranëve madje do të thosha edhe në kurriz të socialistëve të ndershëm dibran ka ngritur një sekt me qëllimin e vetëm për të grabitur pasuritë e kësaj zone për të nëpërkëmbur banorët e kësaj zone dhe për ta kthyer atë në një çiflig të tekave të tij personale.

Drama e mbylljes së filialit të Peshkopisë është një dramë që ndihet në çdo familje të kësaj treve. Kostoja e arsimit të fëmijëve dibranë është shtuar, ndërkohë që është shkullur padrejtësisht ajo që duhet të ishte një vatrë jo vetëm për trevën e Dibrës por për të gjithë Shqipërinë verilindore dhe jo më kot në programin tonë ne kemi vendosur arsimin e lartë si një prioritet absolut dhe hapjen dhe rihapjen e institucioneve të arsimit të lartë me fokus të veçantë tek trajnimi profesionalë i rinisë. Javët e fundit duke përfshirë edhe ditët e fundit unë kam qenë në kontakt me institucionet europiane dhe me universitetet europiane të cilat do të na ndihmojnë ta bëjmë këtë realitet, do ta ndihmojnë së pari duke ju përgjigjur financimeve të qeverisë së re pas 25 prillit me financime europiane, duke na vënë në dispozicion trajnues të cilët do të përgatisin jo vetëm studentët por edhe pedagogët e ardhshëm në degë të veçanta me interes të madh për ekonominë

(Vijon në faqen 3)

Pas Peshkopisë, kreu demokrat Luzim Basha është ndalur në Bulqizë, ku ka premtuar se brenda 6 muajve të para në qeverisjen e tij do t'u japë statusin e minatorëve. Sipas tij ky është detyrimi më i vogël për minatorët, si e drejtë themelore e tyre

Basha në Bulqizë: Statusi i minatorëve do të jetë realitet brenda 6 muajve të parë të qeverisjes

“Ne e dimë që në detin e vuajtjeve spikat ajo e minatorëve të Bulqizës, naftëtarëve të Ballshit, ndaj kam ardhur sot këtu, për të shpallur e bërë të njohur një nga ndryshimet kryesore të qeverisë time, për resurset minerale. Ndaj dua ta përsëris, nga ky shesh i Bulqizës, për çdo minator nga Bulqiza, minator shqiptar, për familjet e tyre dhe fëmijët e tyre, për sindikatat e minatorëve dhe pensionistët minatorë që kanë shpenzuar jetën e tyre nën tokë.

Qartë, prerë e shkurt, brenda 6 muajve të parë qeveria ime do të miratojë statusin e minatorit sipas parimeve Evropiane.

Kjo është më e pakta dhe detyrimi më i vogël për ju, fëmijët tuaj, për shkollimin e tyre, sigurimin e jetës së tyre.

Brenda 6 muajve të parë në dialog dhe në konsensus me përfaqësuesit tuaj statusi i minoritit do të jetë realitet. Do heq traun në rrugën e Kombit. Detyra e parë e atij që kërkon votën për të qeverisur është të mbaj zotimet. Ndaj kam ardhur këtu të votohem prej jush, sepse statusi i minoritit do të jetë i garantuar me PD dhe qeverinë e ar-



hshme". Ai i ftoi ata që më 25 prill të bashkohen për ndryshimin dhe për të garantuar të ardhmen në Shqipëri.

“Ju ftoj të investoni tek ndryshimi që po vjen, të shkoni derë më derë, tek minatorët, fermerët e Bulqizës

dhe t'i bëni pjesë e ndryshimit tonë të madh më 25 prill. Ora e ndryshimit po troket si asnjëherë tjetër, shqiptarët do të kenë një orë vendimtare për ju, fëmijët tuaj dhe për atë që do të ndodhë. A do të shkojmë drejt Ev-

ropës a do të mbetemi në fund të vendeve të Rajonit.

Nuk shkohet në Evropë me shëndetësi të rrënuar, nuk shkohet pa respektuar punën, nderin, minatorët e fermerët”.


Basha me intelektualet dibrane: Përfundojmë Rrugën e Arbërit dhe rihapim Universitetin

(Vijon nga faqja 2)

dhe për investimet e huaja dhënë këtë kuadër. Synimi është që në veçanti në zona të lëna krejtësisht jashtë vëmendjes, të braktisura në mënyrë, do të thoja kriminale, siç është veriu dhe verilindja, ku si rezultat emigracioni ka marrë përmasat më të rënda në gjithë vendin, nga Gjirokastra në Shkodër, nga Korça në Durrës emigracioni i të rinjve është kthyer në plagën më të madhe të vendit, po në këto zona edhe më shumë. Pra synimi është që ne të krijojmë kushte të përshtatshme, për t'i dhënë të rinjve të kësaj zone jo thjeshtë një diplomë, por një arsimim, një kualifikim profesionalë të nivelit të lartë për t'i përgatitur ata për një vend pune me pagë të mirë dhe për mundësinë për të themeluar jetën e tyre pranë familjeve të tyre, pranë komunitetit të tyre. Trajnimi i rinisë, sjellja e investimeve të huaja, rihapja e filialit i profilizuar për të prodhuar kuadro për përgatitur, profesione të përgatitura për këto investime dhe pa diskutim vëmendja e shtuar për disa nga investime strategjike për të cilat kanë interes parterët tanë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të sjellë këtu vëmendjen edhe të investitorëve të tjerë në fusha të ndryshme ku fokusi do të jetë teknologjia e informacionit, pra teknologjia kompjuterike e informacionit, e komunikimit, do të jetë industria auto-motive, do të jetë industria semikondutorëve dhe pa diskutim do të jetë mbështetja e veçantë për bujqësinë dhe për turizmin, të cilat përbëjnë ndoshta mbi 50% të potencialit zhvillues ekonomik të zonës së Dibrës, krejtësisht të pa prekur.

Padiskutimi përfundimi i Rugës së Arbërit do ta bëjë Dibrën një nga qendrat më të afërta me kryeqytetin dhe do të nxisë kësisoj jo thjesht trafikun, por dhe shkëmbimin ekonomik me qendër më të madhe ekonomike të Shqipërisë, do ta sjellë shumë më afër edhe infrastrukturën turistike të turistëve të cilët janë dhe duhet të jenë në të ardhme një nga prioritetet tona për ti njohur jo thjesht

me bregdetin por me gjithë bukuritë e mahnitshme të Shqipërisë. Dhe nga ana tjetër kjo do të sjellë një ndihmë të madhe për bujqësinë Dibrane, për pemëtarinë Dibrane, për blegtorinë Dibrane, produktet e të cilës janë me nam për nga cilësia, për nga natyra e tyre unike, por të cilave iu ka munguar si kudo në Shqipëri subvencionet, iu ka munguar mbështetja me investime në infrastrukturë, iu ka munguar vëmendja dhe mbështetja e gjithanshme e shtetit duke përfshirë investimin e personave të specializuar, agronomëve, veterinerëve, të cilët do të bëjnë të mundur që fermeri Dibran të sjellë produktin e tij unik, produktin e tij bio dhe cilësor, me një çmim të përshtatshëm në treg, jo për të mbajtur frymën gjallë por për të krijuar mirëqenie dhe për të rikrijuar traditën e jetës me tokën dhe ajo pjesë e rinisë që do të jetojë në tokën e stërgjyshërve të vet, mos ta bëjë kështu prej hallit por ta bëjë sepse sjell një leverdi të madhe. Këtu lidhen pra, të gjitha dimensionet e ekonomisë së Dibrës, duke përfshirë këtu, edhe lehtësimin e komunikimit me pjesën tjetër të kësaj treve, që ndodhet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që ekonomia të funksionojë si një e tërë. Unë e di që edhe pa këto shanse, madje edhe duke e pasur qeverinë kundër, shqiptarët në përgjithësi e dibranët në veçanti kanë qëndruar fort. Tetë vite premtime të pambajtura, tetë vite pa asnjë zgjidhje për Dibrën, po marrin fund! Kështu që mençuria dibrane, besoj do t'i prijë ndryshimit, ndryshimit që do sot gjithë Shqipëria! Do t'ia mbyll derën të keqes! Nuk do t'ia hapë për një herë të tretë, e do të bashkohet me ekipin tonë, që janë përfaqësues të vlerave më të mira të Dibrës, njerëz të sprovuar të suksesit, kur i është besuar administrimi i punëve publike”, deklaroi kryedemokrati Lulzim Basha.



Kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha është pritur me entuziazëm të jashtëzakonshëm në Maqellarë

intervista

“Ndryshimi po vjen”, - Basha në Maqellarë: Këtë entuziazëm ta çojmë në fshatin më të largët

Në fjalën e mbajtur para mijëra pjesëmarrësve që kishin dalë për ta prituri nga të gjitha fshatrat e Maqellarës të shtunën e 10 prillit 2021, Kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha tha se ora e ndryshimit po afron, ndërsa u kërkoi mbështetësve që ta çojnë entuziazmin deri në fshatin më të largët.

“Të dashur vëllezër dhe motra, zonja dhe zotërinj, të rinj dhe të reja! Kurrë s’e kam parë Maqellarën kaq plot! Plot me besim, plot me vendosmëri!

Kjo nuk është thjesht një dashuri mes nesh, kjo është një ftesë ndaj çdo dibrani për t’ju bashkuar ndryshimit më 25 prill! Për t’ju bashkuar Partisë Demokratike dhe Aleancës për Ndryshim në mënyrë që të gjithë së bashku të hapim rrugën e mirëqenies, rrugën e punësimit, rrugën e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European.

Ju ftoj që këto ditë që na ndajnë nga



BASHKË PËR NDRYSHIM

SHQIPËRIA FITON

VOTO

9

Partia Demokratike

EDMOND ISAKU

SHANSI për të ndryshuar jetën tuaj ka numrin 4!

Votoni EDMOND ISAKUN

Deputeti që ju dëgjon, ju respekton dhe ju mbron!

VOTO Nr. 4



EDMOND ISAKU

25 prilli, këtë entuziazëm, këtë besim ta çojmë derë më derë, në fshatin më të largët, ta çojmë shtëpi më shtëpi, familje më familje që kërkojnë rrugën e shpresës, rrugën e ndryshimit. Të gjithë ata që tetë vite me radhë u kërrusën, u gjunjëzuan e humbën besimin tek vetja e tyre. Ora e ndryshimit po afron për të gjithë ju, bashkë për ndryshim. Maqellara fiton, Dibra fiton, Shqipëria fiton” – tha Basha.

BISEDA ME PRONARIN E BIZNESIT TË VOGËL

Gjatë ecjes në qytet, Basha është ndalur nga pronar biznesesh të vogla, ku ka dëgjuar problemet që kanë me taksat, çmimin e karburantit dhe energjisë elektrike. Basha tha se ndryshimi më 25 prill do të thotë ulje e taksave, uljen e karburantit dhe energjisë elektrike.

Lulzim Basha: Si po ju shkojnë punët?

Qytetari: Blozë fare!

Lulzim Basha: Si kudo në Shqipëri.

Qytetari: Si në pandemi, zero! As drita, paguajmë qiranë, punëtorin. Me humbje! Në Maqedoni është nafta lirë, marrim makinat, shkojmë i furnizojmë atje.

Lulzim Basha: Serboratorët i mbushin dibranët në Maqedoni, kuki-sianët në Kosovë. Më 25 Prill të votojmë të gjithë për ndryshimin dhe ndryshimi do të ndihet kudo. Një nga fushat kryesore do të jetë kostoja, kostoja e prodhimit, nafta, energjia, ulja e taksave, heqja e terrorit të administratës tatimore.

Do t’ju bëj, në radhë të parë, të ndiheni të çliruar nga ana psikologjike dhe nga ana e dytë do të ndez prapë besimin dhe motorët e ekonomisë. Se vetëm kështu vjen konsumi, forcoheni ju, forcohet biznesi i vogël, forcohet Shqipëria. Ju ftoj të gjithë, me biznesin e vogël kemi një marrëdhënie shumë të ngushtë, kemi nënshkruar një marrëveshje, e cila do të jenë realitet të gjithë zotimet tona. Mos u dorëzoni! Të gjithë bashkë për ndryshimin!



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha teksa kthehej nga Dibra për në Tiranë ka dhënë një mesazh për të gjithë shqiptarët, që në 25 prill të votojnë ndryshimin.

Basha mesazh për shqiptarët:

Për ju që besoni se Rama nuk sjell ndryshimin, bashkohuni me shumicën dhe votoni PD!

- Basha shprehet ndër të tjera se për ata që nuk besojnë më se Rama mund të sjellë ndryshimin, të bashkohen me shumicën dërrmuese dhe të votojnë PD, Nr.9 dhe Aleancën për Ndryshim



“Ju përsëritet në fund të ditës time në Dibër. Qytetarët janë të etur për ndryshim. Në fund të kësaj dite, pasi do vijoj me aktivitetet e mia në Tiranë. Dua t’i drejtohem qytetarëve shqiptarë se këto javë në udhëtimin tim nga jugu në veri, kam ndjerë etjen për ndryshim. 8 vitet e fundit kanë qenë vuajtje për popullin tonë. Të gjithë e kanë kuptuar se na duhet ndryshim rrënjësor. Aleanca për Ndryshim dhe PD, unë ju ftoj ju të gjithëve që e keni të shtrenjtë Shqipërinë, ju të gjithë që besoni se ky vend mund të qeveriset ndryshe, që besoni tek transparenca, që besoni se paga minimale mund të rritet. Ju të gjithë që besoni se anëtarësimi në BE është garanci për suksesin e Shqipërisë dhe të familjeve shqiptare. Ju ftoj, për ju që besoni se Rama nuk mund të sjellë ndryshimin.

Aleanca për Ndryshim ju bën thirrje: Bashkohuni me ndryshimin e Shqipërisë. Pavarësisht bindjeve politike, bashkohuni me shumicën dërrmuese që duan të

sjellin shpresën për ndryshim. Voto Nr.9 , bashkë për ndryshim, Shqipëria fiton”, shprehet Basha.

Nuk mund t’i hapet me për herë të tretë dera një njeriu, i cili për 8 vite ka varfëruar shqiptarët BASHA NË BURREL: KEMI NJË QËLLIM, TA KTHEJME SHQIPËRINË TEK PRONARËT E VËR-TETË

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha nga Burreli tha se qëllimi është që pas 25 prillit ta kthejnë Shqipërinë tek pronarët e vërtetë.

Në fjalën e tij, kreu i PD u shpreh se nuk mund t’i hapet me për herë të tretë dera një njeriu, i cili për 8 vite ka varfëruar shqiptarët.

“Pas 8 vitesh më shumë se kurrë rraskapitje, varfëri dhe papunësi, shqiptarët e kanë ndarë mendjen. Të rinj e të reja, burra dhe gra. Problemet kanë zgjidhje tek programi i PD. Kemi vetëm një qëllim, ta kthejmë

Shqipërinë tek pronarët e saj të vërtetë. Më 25 prill ky bashkim i madh shpirttrash, i duhet dhënë përgjigje vetëm një pyetje, a mund të vazhdohet më kështu?

A do ja hapni derën për herë të tretë? Të bashkoheni për ndryshim. Të votojmë për familjet tona, për fëmijët, të votojmë numrin 9. Për ndryshimin. 8 vite vend-numëro, pa negociata, apo do më jepni mundësinë të hapim rrugën drejt Europës.

Jemi të ndryshëm në këto bashkime të mëdha, por një gjë na bashkon, etja për ndryshim. Le të ushtojë nga kjo trevë që i nxori themeluesit e shtetit modern shqiptar, të ushtojë thirrja bashkë për ndryshim. Të djathtë e të majtë, bashkë për ndryshim. Shqipëria fiton!”- tha Basha.

“NË MESIN TONË JANË EDHE SOCIALISTËT E ZHGENJYER”/ BASHA: 25 PRILLIN DO TA KTHEJME NË REFERENDUM. RAMA I TREMBET...

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha para mbështetësve në Klos u shpreh se me demokratët janë bashkuar edhe socialistët e zhgënjyer.

Basha u shpreh se tani ka ardhur ora e ndryshimit, ndaj ftoi të gjithë që në 25 prill të votojnë Partinë Demokratike.

Sipas tij 25 prilli do të jetë referendum, ku Shqipëria do të marrë kthesën e duhur dhe do ti mbyllet dera tranzicionit.

“E sotmja ka nisur në Dibër, Maqellarë, Bulqizë, Klos dhe ashtu si kudo tjetër është e pamundur të mos emocionohesh nga energjia e shqiptarëve, që nuk ka forcë ta ndalë. Tetë vite arrogancë, varfërim, 8 vite gënjeshtër nuk lahen me 8 javë sharje dhe baltosje. Koha për ndryshim, ora për ndryshim po afron.

Në mesin tonë nuk janë vetëm demokratët luftëtarë e demokracisë, qëndrestarët e shtetit të së drejtës, por edhe socialistët e zhgënjyer, të cilët janë bërë bashkë me demokratët për ndryshim.

Ndryshimi është përgjegjësi, është privilegj.

25 prilli nuk bëhet për një njeri apo për një parti. Por që të gjithë bashkë të hapim dyert e Europës.

25 prillin do ta kthejmë në referendumin kur Shqipëria do të marrë kthesën e duhur dhe duke mbyllur derën e tranzicionit. Rama i trembet bilancit zero të premtimeve të pambajtura”, u shpreh ndër të tjera Basha.



EDMOND ISAKU: SË BASHKU PËR FITOREN E MADHE, ME LULZIM BASHËN KRYEMINISTËR-PROJEKSION I SHQIPTARËVE MË VOTONI, DO TË PËRFAQËSOJ INTERESAT TUAJA NË PARLAMENTINE RI SHQIPAR...

Të nderuar miq!

*Tashmë që gara elektorale ka startuar, dhe mu a m'u dha besimi nga
leadershipi demokrat të jem Nr.4 në listën e kandidatëve të PD në qarkun
e Dibrës, shpreh bindjen e palëkundur në mbështetjen tuaj, për të mak-
simalizuar votën për PD-në dhe për të garantuar FITOREN TONË TË
MADHE.*

Kandidimin tim e konsideroj vlerësim maksimal të kontributit dhe karri-

erës time gati 30-vjeçare për Partinë Demokratike...

*Kam besim të plotë në mbështetjen tuaj dhe të gjithë qytetarëve të Dibrës,
Matit, Bulqizës, Maqellarës, Shpenzës e Gjoricës, Ostrenit, Trebishtit e
Okshtunit, Zerqanit, Fushë Bulqizës e Martaneshit.*

*Le të punojmë së bashku, shtëpi më shtëpi, familje më familje e me këdo
që dëshiron ndryshimin e shumëkërkuar.*

I juaji
Mond Isaku

VOTO PR Nr.9 – Voto kandidatin EDMOND ISAKU me nr.4 Edmond ISAKU – PROFILI I INTELEKTUALIT DHE BIZNESMENIT TË SUKSESSHËM

- *Edmond Isaku u lind në Grazhdan të Maqellarës dhe rrjedh prej një familjeje të njohur patriotike të zonës. Me edukatën e korrektësinë, të trashëguara nga prindërit e tij u angazhua përditë në punë duke përforsuar bindjen e tij se vetëm duke guxuar mund të shkonte përpara, të çante edhe në sipërmarrje të tilla të guximshme. Motoja e tij ishte dhe është: me punë dhe vetëm me punë do të mund të ndërtohet të ardhmen që ëndërron*

Kushdo që ka patur rastin të vizitojë qytetin minator të Bulqizës, që pas janarit 2017, është mrekulluar me kompleksin multifunksional: Hotel, BarRestaurant, salla konferencash si dhe godina e TV BULQIZA, në pronësi të “Mariuxho” sh.pk. me administrator Z.Edmond Isaku. Tashmë, inteligjenca dhe rinia e këtij qyteti, por dhe institucionet e kanë bërë zgjedhjen e tyre, duke i realizuar takimet, eventet, festat e konferencat shkencore, pikërisht në ambjentet mjaft të këndshme të këtij hoteli të standardeve europiane.

Emri i Edmond Isakut është skalitur tashmë edhe te ky investim i konsiderueshëm për ngritjen e të parit kompleks multifunksional: hotel, bar-restorant sidhe godina e TV BULQIZA. Është kjo një vepër turistike me performancë cilësore që sjell shërbim modern në këtë qytet të aneksuar të Shqipërisë.

Qoftë edhe vetëm për këtë vepër, Mond Isaku mund të konsiderohet si përfaqësuesi i vlerave më të çmuara intelektuale të brezit të ri, me një integritet shumë të lartë moral dhe intelektual.

Ekrani me logon “Tv Bulqiza”, më i preferuari në qarkun e Dibrës

Në teorinë konstruktiviste moderne, njeriu jo vetëm duhet të dijë gjëra por duhet të bëjë gjëra. Edmond Isaku është kompetent që t'i zbatojë njohuritë e tij në situata kontekstuale. Ai ka përvojën, moshën, fuqinë intelektuale, morale, materiale që t'i përkushtohet sipërmarrjes. Dhe këto, të krijuara jo në një ditë apo në një vit, por për një hark kohor të konsiderueshëm. Ideja dhe iniciativa e ngritjes të të parit televizion privat në Bulqizë i përket pikërisht Edmond Isakut.

Afro tri dekada më parë kur ai ideoi dhe implementoi projektin e ngritjes së TV Bulqiza, pati edhe skeptikë që e shihnin me dyshim, por realiteti provoi të kundërtën. Ekranin me logon “TV Bulqiza” u bë më i preferuari për qindra mijëra teleshikues, jo vetëm nga qyteti minator në prehër të maleve, por edhe për audiencën e tij deri në Burrel e Kala të Dodës, me shtrirje në rang qarku.

Edmond Isaku njihet si një njeri me reputacion të mirë në rrethin e Bulqizës dhe në zonën e vendlindjes së tij në Maqellarë...dhe pothuajse në krejtë Qarkun e Dibrës, si dhe në Tiranë e Durrës. Ai është një person që ka punuar prej më se dy dekadash në sektorin privat në punë dhe investime modeste, duke fituar me djersë dhe ndershmëri. Asetet me impakt publik, si TV Bulqiza, firma “Mariuxho” sh.pk., Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë Valorë Kombëtarë që ai drejton si dhe gazeta kulturore atdhetare “Bulqiza”, janë vepër e krijimtarisë individuale të Mondit i cili me inteligjencë, me intuitë, i orientuar mjaft mirë në ekonominë e tregut ka patur gjithmonë sukses.

GAZETA “BULQIZA”, ZË I SPIKATUR NË TREGUN MEDIATIK SHQIPTAR

Mond Isaku nuk është i apasionuar vetëm pas biznesit. Ai është një sipërmarrës i suksesshëm të cilit i pëlqen t'i japë komunitetit. Është bashkëthemelues i gazetës “Bulqiza”, të cilën e drejton me kompetencë e profesionalizëm që prej pesë vitesh. Gazeta “Bulqiza”, nën drejtimin e tij, si zë i spikatur në tregun mediatik shqiptar, solli frymën bashkëkohore

BASHKËNDRYSHIM SHQIPËRIA FITON

VOTO 9

Partia Demokratike

EDMOND ISAKU

SHANSI për të ndryshuar jetën tuaj ka numrin 4!

Votoni EDMOND ISAKUN

Deputeti që ju dëgjon, ju respekton dhe ju mbron!

VOTO Nr. 4

EDMOND ISAKU

të zgjidhjes së problemeve të qytetit e të fshatrave, duke evidentuar faktorë objektivë e subjektivë që ndikojnë në ecjen përpara, në kapërcimin e krizës ekonomike e të mungesës së besimit, për të gjallëruar forcat e brendshme lëvizëse të njerëzve tanë, të freskimit të veprimtarisë publike e shtetërore në të gjitha nivelet. Kjo gazetë ka promovuar dhe promovon atë çka vjen si vlerë nga e kaluara dhe i flet të sotmes me një pasqyrim real të problematikave të shumta që ka sot komuniteti i këtij rrethi. “Gazeta “Bulqiza”, natyrisht nuk do të kishte mundësi të botohej pa mbështetjen financiare të z. Edmond Isaku, administratori i TV-Bulqiza dhe i kompanisë “Mariuxho” sh.pk. që merret me nxjerrjen e mineralit të kromit.

Edmondi duke qenë edhe kryetar i shoqatës së rrjeteve kabllore dhe televizioneve lokale ka fituar një përvojë të shkëlqyer mbi mediat elektronike dhe të shkruar, duke u bërë faktor në komunikimin publik dhe emancipimin e përgjithshëm kulturor.

Përvoja e gjatë si këshilltar bashkiak i ka dhënë mundësi Mondit që të njoh në detaje problemet ekono-

mike shoqërore të Bulqizës. Ndaj i nxitur nga këta stimuj mjedisor, rreth tri dekada më parë ngriti televizionin lokal i cili tani është fuqizuar në përhapjen e valëve dhe në cilësi programe transmetimi. Po ashtu edhe në rindërtim të ideve të reja dhe të vizionit për të ardhmen.

ISAKU, INVESTIM EDHE NË BOTËN DIXHITALE

Edmond Isaku ka punuar ndër vite në sektorin privat duke respektuar ligjet dhe rregullat e shtetit ligjor dhe të ekonomisë së tregut. Është i pa implikuar me detyra publike dhe afëra me fonde publike. Lajtmotivi i tij është: “E dua qytetin tim Bulqizën dhe gjithë investimet e mia në fushën e medias, të ndërtimit dhe nxjerrjes së kromit, i kam fokusuar pikërisht në këtë qytet, duke punësuar dhe mbështetur qindra familje”.

Edmond Isaku u lind në Grazhdan të Maqellarës dhe rrjedh prej një familjeje të njohur patriotike të zonës. Me edukatën e korrektësinë, të trashëguara nga prindërit e tij u angazhua përditë në punë duke përforsuar bindjen e tij se vetëm duke guxuar mund të shkonte përpara, të çante edhe në sipërmarrje të tilla të guximshme. Motoja e tij ishte dhe është: me punë dhe vetëm me punë do të mund të ndërtohet të ardhmen që ëndërron. Vitet e fundit ai është investuar edhe në botën dixhitale, ku tashmë ka disa abonentë të rrjetit kabllor. Si drejtues i një firme kromi, drejtori i “TV Bulqiza” dhe i gazetës së këtij rrethi, kryetar i Shoqatës të TV kabllorë kombëtare dhe njëkohësisht ish- këshilltar në bashkinë e Bulqizës, M.Isaku ka mjaft reputacion dhe një emër të mirë në këtë rreth. Ai njihet për karizmen dhe për një dashamirësi të admirueshme ndaj komunitetit.

Në një këndvështrim të përgjithshëm, të jesh një sipërmarrës është çështje talenti, por është edhe një dhuratë nga Zoti. Edmond Isaku i ka të dyja. Ai ka dëshmuar se është një sipërmarrës i suksesshëm dhe i guximshëm, ka ide, aftësi menaxhuese etj. Si i tillë ai zë vend të veçantë në Pantheonin e Vlerave.

NJË LIBËR I VOGËL ME IDE TË MËDHA



DR. HAJRI MANDRI

Kriza shumëplanëshe që e ka mbërthyer shoqërinë shqiptare dhe sidomos rënia psikomorale nën dilemën “bëhet apo nuk bëhet ky vend”, kishte nevojë për një përgjigje nga dikush që ka prerogativë për të ndikuar në ndryshimin e statukusë. Ky përfytyrim estetik mbi kapërcimin e krizës dhe zhvillimin tonë shoqëror ekonomik e kulturor ka të bëjë me përtëritjen e ndjenjës për të jetuar në këtë vend, për t’u rikthyer besimin për një cilësi më të mirë jete. Libri vjen në një moment ndriçimi e iluminimi përkundrejt një konfuzioni ideopolitik, etikomoral dhe estetik që ka të bëjë me rendin e vlerave në një shoqëri të zhvilluar dhe të emancipuar.

Libri është një ese e gjatë politiko-filozofike që ka në qendër raportin e njeriut me politikën në kontekstin aktual shqiptar. Autori e hap këtë databazë ideshë politike, shoqërore, ekonomike, filozofike, estetike e morale me një prezantim të origjinës së tij duke u bërë i dashur dhe konfident me lexuesin. Natyrisht në horizontin e pritjes, audienca kërkon të dijë çfarë do ndodhë me të nesërmen e saj. Autori, i cili është kandidati i afërm për kryeministër, i cili do të marrë në dorë misionin e rëndësishëm të drejtimit të vendit portretizohet në sfondin elektoral të së djathtës shqiptare, e cila mbështetet në principet e të djathtës konservatore europiane që ka në themel kombin, familjen, pronën, lirinë individuale dhe besimin fetar. Këtë pozicion të tij autori përmes shembëlltyrave nga e kaluara sjell koherencën në qëndrimin dhe vlerat e tij dhe të familjes së origjinës. Autori i bindur dhe besimplotë në fuqitë e tij intelektuale e afësitë konceptuale, shpjegon arësytën e angazhimit të tij në politikë duke argumentuar joshjen dhe admirimin drejt prires si kontribut i individit që përmban dhe gjenëron ide konstruktiviste në shërbim të humanizimit të shoqërisë, përmes pjesëmarrjes aktive në aksion politik si ngashnjim i kënaqësisë estetike që sjell transformimi ekonomik e kulturor i një shoqërie. Kjo prire estetike si luftë dhe sakrificë për të zbuluar jetën shoqërore, kombëtare e ka thirrur protagonistin në nisma të suksesshme me një karrierë brilante, e mbështetur nga predispozitat individuale dhe dhuntitë e tij.


Autori Lulzim Basha prek raporte të rëndësishme filozofike që kanë të bëjnë me raportin e qytetar-politikë dhe shtetas-shtet. Duke analizuar këto raporte në kontekstin shqiptar, ne kuptojmë se ftohja e njeriut me politikën vjen si zhgënjim nga mashtrimet elektorale, nga mungesa e racionalitetit, nga metodologjia qeverisëse, nga papërgjegjshmëria e sipërmarrësve politikë dhe nga abuzimi me pushtetin. Ilustrimi më i plotë në libër është mënyra e mbrapshtë qeverisëse e të majtës shqiptare veçanërisht në dy mandatet e fundit të Edi Ramës. Idetë politike të Bashës i kundërqendrojnë me argumente të forta si alternativë krejt ndryshe në filozofi dhe politikë me atë të qeverisë aktuale të majtë. Regresi ekonomik, shoqëror, kulturor, rënia e cilësisë së jetës në të gjitha fushat e jetës, gjejnë një analizë përmes metodës ballafaquese duke i vënë përballë programin qeverisës të Partisë Demokratike, e ndjekur nga koalicioni opozitar.

Portreti i krizës aktuale përshkruhet si shkak i kor-

rupcionit të instaluar në sistem. Shoqëria shqiptare po përjeton një kolaps ku kriza shfaqet në të gjitha fushat e jetës dhe veprimtarisë shoqërore. Kemi krizë politike, midis mazhorancës dhe opozitës, krizë intucionale, paaftësi, korrupsion dhe mediokritet në administratë, ministra e kryebashkiakë të shkarkuar për korrupsion, krizë konstitucionale ku gjykatat mbetën të paralizuar nga reforma për vite të tëra, kriza ekonomike që varfëroi në palcë qytetarin, ngriti koston e jetesës dhe shqiptarët u shtërnguan si asnjëherë në jetën e tyre ekonomike, krizë sociale ku papunësia, u rrit dhe njerëzit humbën vendet e punës, kriza morale ku të rinjë morën rrugën e emigrimit pa shpresë për të jetuar në këtë vend, kriza familjare kur jeta e një çifti bëhet e papërballueshme dhe pa rrugëdalje, kriza kombëtare ku në vend të konsolidimit të vlerave tona dhe bashkimit e bashkëpunimit ndërshtetëror bëhet e kundërta drejt përcarjes dhe dezintegritetit, kriza diplomatike që reflektohet në tregues të organizmave ndërkombëtarë që monitorojnë demokracinë shqiptare në rënie duke u larguar më shumë nga Evropa. Modeli i politikës konfliktuale e nxitur nga mazhoranca krijoi ngërce dhe ngecje në vend të zhvillimit ekonomik e shoqëror. Ky degradim kërkon patjetër një përgjigje. Por nuk ka më mirë se të sistemosh idetë dhe zgjidhjet brenda një libri.

Një libër i vogël me ide të mëdha, i shkruar në stilin konciz ku çdo paragraf, çdo fjali ka sens, ka ngarkesën e mendimit, bukurinë dhe thjeshtësinë ligjërimore, i përshtatshëm për një audiencë të gjerë. Lexuesi shqiptar dhe kushdo tjetër do të gjejë të shkruar platformën fundamentale të zhvillimit dhe përparimit të kombit dhe shoqërisë sonë. Shoqëria shqiptare është një shoqëri e re demokratike, një shoqëri që mëson. Kërkesave në rritje për cilësi jete dhe demokracie janë stimuj që prodhon kontekst ynë shoqëror e kulturor kombëtar, përgjigja e politikës në këtë rast nga kryeministri i ardhshëm merr vlera të pallogaritshme në kthimin e shpresës, në rritjen e besimit të politikës, nxit ndjenjat estetike të dashurisë për kombin, atdheun, shtetin, familjen, pronën dhe shton kënaqësinë estetike të jetës.

Mesazhet e mrekullueshme për familjen e shëndoshë janë një vlerësim që thekson formimin kulturor të autorit, edukimin e tij tradicional në familje, në shoqërinë kulturore shqiptare, në historinë e ndritur dhe ëndrrën për ta bërë Shqipërinë më të bukur, janë motivacion i fuqishëm shpirtëror në formimin e liderit të ardhshëm që për fat të mirë është pasuruar në shkollim dhe edukim europianizues.



Autori e vendos personalitetin e tij në raport të drejtë dhe simpatik midis eurocentrizmit dhe etnocentrizmit. Sjellja e tij politike, moderacioni, fryma moderne premtojnë për një ngritje në një shkallë të lartë të përkushtimit të politikës për ndryshim, duke u bazuar në prioritetet bashkëkohore; si zhvillimi i teknologjisë, turizmit dhe bujqësisë, në përshtatje me realitetin shqiptar.

Autori thotë në libër që “njeriu bën gjithmonë atë që i do zemra”, unë do të thosha se veç këtij qëndrimi estetik, njeriu relizon më mirë atë që beson më shumë. Basha ka një besim të patundur në ardhmërinë tonë kombëtare. Besimi lëkund malet thotë një fjalë e urtë shqiptare, dhe Lulzim Basha beson në produktivitetin e ideve të tij, në konstruktivizmin e tij, në kredon dhe përfytyrimin për të ardhmen. Besimi në vetvete është edhe tipar estetik, besimi është fuqi, kur ne shohim besim të plotë e frymëzues rritet edhe admirimi publik për Të, si lider. Basha e koncepton lirinë si burim gëzimi, respektin ndaj njeriut dhe humanitetin e ka të mishëruar në mendje dhe në shpirt, i kundërt me kundërshtarin e tij që sillet me arrogancë si lidër ironik, grotesk, sarkastik, tallës e qesharak.

Koncepti i Bashës për shtetin është një koncept modern, një shtet që ndërhyt sa më pak në jetën e njeriut, në lirinë e tij, një shtet efikas që me rregulla dhe ligje na mbron që të mos abuzojmë me lirinë. Kjo është filozofia moderne që vjen si një kumt e që na fton të gjithëve për më shumë punë, përkushtim e dinjitet. Humaniteti i Bashës del në pah edhe te përshkrimi me emocion i dashurisë për vajzat dhe respekti për bashkëshorten, apo idesë së tij që shteti të ketë fytyrë njerëzore, njeriu në qendër, jo si propagandë por me rregulla dhe ligje që mbështesin kohezionin social apo ekuilibret shoqërorë. Në këtë kumtim autori sqaron me finesë se humanizmi formësohet në mënyrë legjitime te e djathta si filozofi qeverisëse. Politika më shumë se çdo fushë tjetër ka joshjen, ngashnjimin dhe romantikën e saj.

Kjo e ka bërë që Basha të jetë që në fëmijërinë e tij i interesuar dhe i predispozuar për t’u marrë me të. Formësimi në vite i ideve të tij kanë krijuar sistemin e ideve që përbëjnë idealin dhe racionalitetin e tij. Ndaj ardhja e tij si kryeministër në politiken shqiptare është një qasje e ndryshme e lidërshipt, dukuri e re, sjellje e re, mentalitet i ri dhe na shembëllen më shumë me kulturën politike perëndimore. Kryeministri i ardhshëm Basha synon t’i japë fund krizës, të rimëkëmb ekonominë dhe shvillimin shoqëror dhe ta integrojë Shqipërinë në BE.



Jo vetëm demokratët, por intelektualë më në zë të Dibrës e vlerësojnë Xhelal Mziun si promotorin e ndryshimit të shumëpritur

profil

Xhelal Mziu, simbol i ndryshimit dhe i shpresës për Dibrën dhe dibranët

Flasin dibranët: Xhelal Mziu është djali ynë, simbol i ndryshimit dhe i shpresës. Është më afër problemeve dhe zgjidhjes së halleve tona

NGA KORAB RUNJA

Sot kudo, ku ai ka patur dhe zhvillon takime intensive, në lagjet e qytetit të Peshkopisë, Kalanë e Dodës, në Reç, Dardhë e Lurë, Cidhën, Kastriot, Muhurr, Katër Grykët, Luzni, Qendër, Maqellarë etj, ndihet fuqishëm fryma e fitores

Fitorja e Partisë Demokratike dhe e Opozitës së Bashkuar do të nisë nga Dibra. Nuk është rastësi, që edhe sondazhet e porositura nga të majtët e nxjerrin PD-në në Dibrë fituese të thellë me mbi 60 përqind. Në këtë fitore plebishitare, rol parësor ka padyshim organizimi i përsosur i strukturave dhe drejtimi vizionar i drejtuesit politik të PD për Qarkun Dibrë, Z.Xhelal Mziu.

Falë talentit, përvojës, vizionit dhe përkushtimit maksimal, në më pak se një muaj Ai arriti të vitalizojë strukturat e PD në Dibrë, Mat e Bulqizë, duke kombinuar në mënyrë të shkëlqyer propagandën me aksionin politik.

Sot kudo, ku ai ka patur dhe zhvillon takime intensive, në lagjet e qytetit të Peshkopisë, Kalanë e Dodës, në Reç, Dardhë e Lurë, Cidhën, Kastriot, Muhurr, Katër Grykët, Luzni, Qendër, Maqellarë etj, ndihet fuqishëm fryma e fitores.

Xhelal Mziu i priu dhe po i prin këtij "uragani" për të përsëritur në Dibrë fitoren e 22 Marsit 1992. Ish – studenti i Dhjetorit '90, brenda vetëm dy muajve në drejtimin e strukturave dhe PD, dhe jo vetëm, është shfaqur dhe pranuar nga masa e gjerë e dibranëve si një politikan i formuar, i maturuar e imponues ndaj kundërshtarëve të tij. Forca e qartësia e argumentit janë tharmi i imponimit apo më saktë i autoritetit të tij. Si një prej veprimtarëve të Lëvizjes Studentore të viteve 1990-1991, që shpërfaqti idealin e një brezi të ri për ta bërë Shqipërinë si e gjithë Evropa, edhe tani në drejtimin e fushatës elektorale të PD për zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit, Xhelal Mziu



ka shfaqur vizionin e tij perëndimor, duke prezantuar dhe bërë të qartë për dibranët synimin kryesor të qeverisë së PD pas 25 prillit: celjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Ndaj si asnjëherë dhe si askush tjetër deri sot, ai ka arritur t'i bashkojë dibranët rreth alternativës së PD të

shpalosur bindshëm nga lideri demokrat Lulzim Basha, që do të jetë kryeministër i Shqipërisë pas 25 prillit.

Si askush tjetër, ish-kryebashkiaku demokrat i Kamzës për tre mandate, ndër më të suksesshmit në rang vendi, i vlerësuar maksimalisht edhe nga ndërkombëtarët, tashmë si drejtues

politik dhe nr 1 i kandidatëve për deputetë të PD në Qarkun Dibrë mirëpritet dhe mbështetet nga dibranët si simbol i mençurisë, guximit e stoicizmit, që po lë kudo gjurmë të pashlyera në udhën e jetës, e të ndryshimit epokal që po ndodh në Dibrën-zemër e kombit.

Njeri i veçantë, energjik, në sjellje e qëndrime, me një mënyrë të foluri karakteristike, që të mbush mendjen për çdo gjë që flet.

Jo vetëm demokratët, por intelektualë më në zë të Dibrës e vlerësojnë Xhelal Mziun si promotorin e ndryshimit të shumëpritur, që po jep shembull në këtë drejtim.

Ndaj dhe Xhelal Mziu duhet kup-tuar dhe çmuar si vizionar, largpamës, i cili me vendosmërinë e urtësinë e një politikani të spikatur munda të arrijë ringritjen e demokratëve të Dibrës në panteonin e vlerave të demokracisë e qytetërimit.

Mesazhi i qartë që na vjen nga vep-rintaria e tij mjaftë efikase e kësaj peri-udhe në Dibrë është respekti për të, për vlerat individuale të Tij dhe për të kup-tuar se sa lartësohet njeriu kur përkushtohet për shtetin e së drejtës dhe për demokracinë.

Tashmë ai ka arritur t'i bindë dibranët se 25 prilli do të jetë REFERENDUM popullor! Se Dita e kthesës së madhe, dita e ndryshimit po vjen,

Kjo edhe për faktin se Partisë Demokratike i bashkohen përditë e më shumë qytetarë, që e shohin atë si të vetmen shpresë.

Qeveria Basha do të jetë garanci se ky vend do të bëhet, emigrantët do të kthehen në vendin e tyre, më shumë punë do të ketë, më shumë mirëqenie, më shumë shpresë. Dhe mbi të gjitha, Xhelal Mziu i ka bindur dhe po i bind dibranët se qeveria e nesërme e kryeministrit Basha është garante e plotësim-it të kushteve për celjen e negociatave dhe anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.



TV "Bulqiza ka publikuar një foto me pamjen që të ofrohet në segmentin e rrugës së Arbrit, ku kalojnë qindra mjete çdo ditë. Tonelata mbetje inerte të llojeve nga më të ndryshmet janë hedhur buzë rrugës në afërsi të Qafës së Buallit.

Tonelata mbetje e inerte buzë rrugës së Arbërit

Pamja është vërtetë e shëmtuar, pasi aty nuk janë hedhur vetëm mbeturina inerte që dalin nga ndërtimet apo rikonstruksionet që ju bëhen objekteve të ndryshme, por mes tyre ka edhe mbetje plastike



ndihma e ARRSH për të bërë zhblokimet e puse-tave. Nga prezencja e ujit në rrugën e Arbërit mes dy lagjeve të qytetit të Bulqizës rrezikohet të shembet dhe një banesë pranë rrugës. Po kështu pritet të ketë plasaritje dhe carje të shtresës së asfaltit që lidh qytetin e ri me qytetin e vjetër. Në një pjesë të rrugës nga qyteti i ri në qytetin e vjetër është vendosur tabela e cila ndalon qarkullimin në kembe apo me automjete në këtë segment rrugor. Nga vete pamjet filmike shikohet se nga niveli i lartë i ujit janë përmbytur edhe disa biznese dhe automjete.

SHUPENZË, BANORËT:U HELMUAM NGA UJI I PIJSHËM QENDRA SHËNDE-TËSORE JO TRANSPARENTE PËR NGJARJEN

Para disa ditësh, u dëncua nga banorët e Njësisë Administrative Shupenzë, të Bashkisë Bulqizë, se janë helmuar rreth 30 persona. Gazetari i Tv "Bul-qiza" shkoi në vendngjarje për ta ndjekur situatën nga afër, ku kontaktoi me banorë të zonës dhe me familjarë të cilët kanë pasur persona të dyshuar për helmim. Të gjithë personat e intervistuar deklaruan se helmimi ka ardhur nga uji i pijshëm, pas dëmtimit të tubacionit të rrjetit të ujësjellësit dhe përzjerjes së ujit të pijshëm me ujërat e zeza. Këtë dyshim të banorëve për helmim nga uji i pijshëm i ndotur, drejtori i Ujësjellësit të Bulqizës, Asllan Daxha, gjatë një bisede telefonike e ka kundërshtuar duke hedhur poshtë pretendimin se helmimi ka ardhur si pasojë e ndotjes së ujit të pijshëm. Por pamjet filmike të tubacioneve të lidhura në rrjetin e ujësjellësit të Shupenzës të lënë të dyshosh se burimi i helmimit të banorëve mund të vijë edhe nga këtu, pasi tubacionet janë të shtrira në kanal in anës së rrugës ku përzihen ujërat e bardha me ujërat e zeza.

Burime informacione bëjnë me dije se Ndërmarrja e Ujësjellësit në Bulqizë, pas deklaratave të banorëve, ka marrë kampione të ujit të pijshëm në disa pika të rrjetit të ujësjellësit të Shupenzës dhe i ka dërguar për analizë pranë Qendrës shëndetësore Shupenzë. Nisur nga ky informacion gazetari ynë kërkoi të kontaktojë me bluzat e bardha të Qendrës shëndetësore në Shupenzë, për të ditur numrin e personave të helmuar dhe për të kuptuar shkaktuesin e helmimit të tyre. Por nga ana e punonjësve të kësaj Qendre shëndetësore mungoi transparencja, duke e lënë publikun të përfunduar plotësisht për shkaktuesin e helmimit të rreth 30 personave në Shupenzë të Bashkisë Bulqizë.

BULQIZË, BANORËT NË PROTESTË PËR MBROJTJEN E PYJEVE



Dhjetra banorë të fshatit Vajkal në Bulqizë, të mbështetur edhe nga unioni i ekspertëve mjedisor shqiptarë dhe nga vete eksperti mjedisor Sazan Guri, kanë protestuar për të mbrojtur pyjet e fshatit të tyre. Banorët një pjesë e të cilëve emigrant u mblodhën në afërsi të rrugës nacionale, duke kërkuar që kurora e malit të fshatit të tyre të mos preket për shfrytëzim. Banorët akuzojnë pushtetin i cili sipas tyre ju ka dhënë hapsirë firmave të ndryshme të shfrytëzojnë pa kriter pyjet e Bulqizës. ata i kërkojnë të gjitha instancave vendore e qeveritare që të ndërhyjnë sa më parë dhe të mos lejojnë të prekin kurorën e malit të Vajkalit, siç ka ndodhur me masivin pyjor tek liqeni i Zi. Në mbështetje të banorëve e mori fjalën edhe eksperti mjedisor Sazan Guri i cili kërkoi besën e tyre për të shkuar deri në fund mbrojtjes së kesaj pasurie që u a ka falur natyra ketij vendeve dhe ketyre banorëve. Rezistenca e banorëve dy vite më parë të fshatrave Dushaj, Kodra e Danit, Koçaj e Kokërdhak bëri që të mos lejohej prerja e pyjeve në vendin e quajtur "Sheshi Bulqizë".

MBI 1 METËR UJË NË RRUGËN E ARBËRIT



Segmenti i rrugës së Arbërit në afërsi të Qafës së Buallit deri në dalje të qytetit të Bulqizës është e pushtuar nga uji dhe guret në rrugë. Tek mbikalimi i qytetit të ri uji i grumbulluar nga reshjet e këtyre ditëve ka arritur deri në një meter e gjysmë. Kjo situatë e pazakontë ka penguar qarkullimin e automjeteve duke i detyruar të kthehen mbrapsht pasi e kanë të pamundur ta kalojnë këtë segment rrugor. Tv "Bulqiza" kontaktoi me mirmbajtësin e rrugës Abaz Mera, i cili u shpreh se është e pamundur që grupi i punës të beje devijimin e prurjeve të shumta të ujit që ka pushtuar rrugën. Sipas tij të gjitha tumbinat e rrugës së Arbërit janë të bllokuara, ndaj kërkohet



Një analizë të mirëfilltë mjaft të detajuar i ka bërë këtij botimi Prof. Dr. Eshref Imeraj, i cili që në krye të pasthënies nxit lexuesin, kur shprehet: “Lexohet me shumë kënaqësi...”

Vepër shkencore me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore

• *Autori meriton përgëzime jo vetëm për guximin hulumtues, por edhe për dritën që hedh mbi një krahinë të harruar dhe nënvleftësuar nga regjimet dhe administratat qëndore shqiptare. Në fund të fundit Shqipëria është një dhe mbetet një unison ballkanik me vitalitet që po testohet sërish në kohë lirie*

HALIL RAMA
“MJESHTËR I MADH”

PARARENDJA E SHKRIMIT

E lexova me shumë vemendje dhe interes të veçantë librin studimor të veçantë të Prof. Dr. Fatmir Terziu “Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës”. Një analizë të mirëfilltë mjaft të detajuar i ka bërë këtij botimi Prof. Dr. Eshref Imeraj, i cili që në krye të pasthënies nxit lexuesin, kur shprehet: “Lexohet me shumë kënaqësi. Kjo është një vepër me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore”. Por unë do të veçoja vlerat studimore, duke e konsideruar këtë një vepër të rëndësishme shkencore.

TRE DALLESAT TIPOLOGJIKE

Së pari: Që në fillim, autori trajton bindshëm dhe me finesë marrëdhënien mes gurit dhe zjarrit...duke pëshkruar “...prodhimin e produktit të lindur prej gurit dhe zjarrit me produktin që në fakt kishte përdorim të dyfishtë, shëndetësor dhe estetik, të katër faktorët janë të pranishëm: toka, riprodhimi primitiv, puna dhe paraja, kombinimet e ndryshme të cilave përbëjnë historinë e këtij produkti, që u ngjiz si gëlqere, një nga elementët më të rëndësishëm, pas vetë grurit, baltës, rërës dhe drurit në një proces të ngritjes estetike të një banese. Por që nga momenti i shkëlqesës së tyre nga toka, deri në formëzimin e fundit të gurit e produktit të fundit të vënies në shërbim të obligimit njerëzor, si produkt i tij pas zjarrit, gëlqerja, vetvetiu sillen në mënyra gati se gjithmonë kundërshtojnë rrënjësisht lidhjen me zjarrin. Shtëpitë janë të tilla pas së gjithave, por kur zjarri dhe zjarrvënësi nuk kanë arsyen e dhimbjes, natyrisht kundërshtia shkon përtej dhimbjes në të gjitha rrëfenjat, këngët e rrjedhat. Në këtë kornizë të ardhur nga rrëfenjat guri i skalitur në duart e ustait e mbajti zjarrin në shpirt, në zemër e në tërë udhën e tij të ecjes jetike. Sakaq ustai forcoi dashurinë me gurin.” Për analogji, sipas një legjende: kur dibranët e Dibrës së Madhe u vendosën në Tiranë, pas eksodit të 1913-tës, lyen muret e shtëpive dhe të avllive me gëlqere dhe tiranasit u çuditën dhe kujtuan se po i lyenin me qumësht... Jo, ajo ishte gëlqerja që Prof. Terziu e sjell me rëndësinë që ka si element i pazvëndësueshëm në ndërtimtarinë shqiptare ku gollobërdasit dhe dibranët kanë në histori unike si njerëzit që sikur kanë ndërnuat cepe më cep të Shqipërisë duke vënë „vulën“ e qëndresës kombëtare edhe pse gjithmonë nën sulm dhe drejt „detdhedhjes“ nga fqinjët e pangopur..

Së dyti: Gjatë vitit që punoja në ish-këshillin e rrethit Bulqizë për 7 vjet (1991-1997) kam shkelur pothuajse në shumicën e fshatrave të ish-komunave Ostren e Trebisht, ndërsa më parë, në ish - shtëpinë e oficerëve Bulqizë (1997-1991), edhe në disa fshatra të Steblevës, madje deri na Draganin majë maleve. Por veçanërisht, në gazetën “Bulqiza” që themelova dhe nxora rreth 90 nr të saj (1992-1996 në Bulqizë dhe 1015-2020 në Tiranë) kam botuar disa artikuj studimorë të autorëve të njohur nga Golloborda: Hilmi Sadikaj, Velo Cfarku, Agim Bekteshit, Besnik Rama etj, të cilët përveç pozitës gjeografike, pavarësisht dygjuhësisë argumentojnë se shumica e banorëve të kësaj zone janë shqiptarë autoktonas dhe kjo „dygjuhësi“ shpjegohet me tregun dhe etjen për punë të burrave të Gollobërdës historike.

Pa marrë parasysh vëshirësitë e ndërmarrjes së një studimi të tillë në një kohë kur parlamenti i Shqipërisë ka miratuar tashmë ligjin “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, në të cilin ka përcaktuar se minoritetet në Shqipëri janë nëntë, përfshirë dhe pa-



kipen bullgare, të cilësuar si të tillë popullsinë e fshatrave të zonës së Gollobordës, Prof. Dr. Fatmir Terziu, nëpërmjet referencave të shumta, ku unë veçoj prof. Kristo Frashëri, prof. Egerem Çabej, Marin Barleti, Hilmi Sadikaj, arkivat britanike (sidomos mendimtarët e shquar si bizantologu francez Alen Dykelie (Alain Ducellier), dhe historiani anglez Noel Malkolm, etj, është më bindës në këtë kontekst. Kjo sepse argumenton bindshëm se si lëvizjet dhe pushtimet kanë sjellë ndryshime, jo vetëm në konstrukt, por dhe në ADN-në e popujve, krahinave e njerëzve veçmas në Ballkanin që duke qënë „shesh luftime“ shpesh ka përzjerë keqas gjuhëdhe etnitë origjinale.Mjafton të perifrashojmë atë që shkruan në fq. 7: “Se kush janë banorët e një zone të tillë në derivatin e origjinës dhe në diskursin e gjuhës, apo dhe të dygjuhësisë, gjithashtu dhe përsëri për mendimin tim, mund dhe s’mund të përcaktohet nga gjuha që flet dhe shkruan, ndërtimet dhe shenjat e lashta që e rrethojnë aty ku jeton dhe gurët e shkruar nëntokë e mbi tokë. Këta komponentë popullit të kësaj zone, nuk i mungojnë, kur vjen fjala e këngëve të mbetura që edhe në gjuhën e grave dygjuhëfolëse këndohet dhe faktohet se “Rosa rosit vo arbanoshka zemja...” (vesa veson në tokën arbërore...) por i mungon dëshmia e shkruar, i mungon madje mjaft arsyeja e gjuhëve të shumta mbi këta gurë, i mungon, ajo që të tjerët në shekuj e bënë sipas rrethanave të tyre për të nxjerrë në pah “orriginën” dhe mbi të gjitha dhe “dominimin” e dëshirave të hershme të shtrirjes masive territoriale”.

Së treti: Këto teza autori i shtjellon duke sjellë fakte dhe argumenta në tre pjesët e para të kësaj vepre. Në pjesën e parë “Golloborda nga memoria”, nga artikulli “Emri, rrjedhat dhe gjuhët”, prof. Terziu ka si referencë “Defteri Osman” i vitit 1467, të cilin e solli në vëmendje për herë të parë në këtë drejtim historiani Hilmi Sadikaj (1999), duke theksuar se “kjo krahinë ka qenë e regjistruar me emrin “Dullgoborda ose Dollgobërda”. Pra, emri i kësaj krahine vjen nga bullgarishtja e vjetër dhe do të thotë në shqip “kodër (bordo) e gjatë (dollo). Ky toponim gjendet i pranishëm pjesërisht në emërtime lokale vendesh, si në Trebisht (kodra përballë lagjes Kasaj të fshatit, që quhet “Borda” nga banorët vendas), në Steblevë (në formën Vetarno Bordo), në Rekë (Velebordo) dhe në Vollnisht (Ternino Nebordo) (fq.22).Gjithashtu autori, në pjesën e parë të kësaj vepre na njeh me traditat e shkëmbimit dhe mjeshtëritë, me njështrit duarartë të Gollobordës, me kostumet tradicionale të grave të



kësaj krahine si dhe me ritet në dasmat, gëzimet dhe përcjelljet njerëzore.

STUDIMI ME BAZA SHKENCORE

Pjesa e dytë e librit si zanafilla e studimit na sjell në vëmendjen e lexuesit e sidomos të studjuesve Vajtmet e Gollobordës, ndërkohë që më pas në artikullin “Trazim kulturash” nguron ta japë përgjigjen shpejt dhe përciptazi. Kjo sipas tij për faktin se, studimi duhet të kalojë së pari në të gjitha pikat ku ravijëzohen ritet familjare, lindja, dasma, lamtumira, mbyllja e rrethit të jetës njerëzore, të gjitha ato që bëhen momentet më të rëndësishme në tërësinë e një treve, ato që shënojnë tranzicionet e saj kulturore më të rëndësishme.

Interes paraqesin për lexuesin edhe ato çfarë shkruan autori për vllahët dhe “jevgit” e Gollobordës. Mendoj se impresiunuese është pjesa e tretë dhe më e rëndësishme e vepërës mbi “Toponimet si Qasje Etimologjike”. Bazuar në toponiminë si kërkim shkencor të emrave të vendeve, origjinës së tyre, kuptimeve, përdorimeve dhe tipifikimeve, prof. Terziu sjell fakte se si mjaft vende të krahinës së Gollobordës kanë marë emërtimet e tyre nga toponimet. Pa u zgjatur, për këtë mjafton të lexojmë artikujt e kësaj pjese të vepërës me tituj mjaft intrigues: “Vajtimi i kukuva-jkave”; “Guri i lotit”; “Tre lisat”; “Dardha e bekuar”; “Zogu i jargavanit”; “Guri i Xhemos”; “Qershitë e Lamos”; “Raven” u ngjiz nga i Huaji”; “Radec’, toponimi që flet qartë”; “Kodra e Shutecit”; “Krasta’ emri që rrëfen”; “Arra budallaqe”; “Rebori”; “Smilen”; “Kallogeri”; “Presllop”; “Dragalicë”; “Truku i Bellavodas”; “etj. Ndërsa për Kështjellën e Trebishtit, ndër më të njohura e kësaj zone autori shkruan se: “Një nga emrat më të lakuar prej kohësh, që ka ngjizur toponimin më befasues dhe më tipologjik të kësaj treve lidhet me toponimin ‘Gradishtë’, që do thotë qytezë. ‘Gradishtë’ quhet vendi në fshatin Trebisht Çelebi, për të cilin hamendësohet se kohë më herët e kanë cekur në shkrimet e tyre Dhimiter Frangu dhe Marin Barleti”.

Vështrimin etnokukulturore të autorit për zonën e Gollobordës e ndeshim në pjesën e 4-t të këtij libri “Ballkani përtej “njëjësit”. Këtu, veç të tjerash prof. Terziu na njeh me vallen pa ‘njëjës’ “Pajrushka”, me origjinën e këngës “72 ditë”, ku e gjithë kënga interpretohet kështu: “Shtatëdhjetë e dy ditë/Ka një plagë në zemrën time/Nuk është plagë nga sëmundja/Tashmë është plagë dhe pikëllimi./Merre pushkën dhe më vrit mua/pastaj më thuaj se s’të dua”.

Në këtë vepër të rëndësishme shumëdimensionale (studimore, etnokulturore) autori argumenton edhe “Këngët si mesazh unik” si dhe Gollobordën si zonë shumëgjuhëshe.

Ndërkohë, duke u ndalur tek “Regjistrimi i Tetorit 2020” lehtësisht evidentojmë shqetësimin e autorit për kushtin bullgar në lidhje me marrjen e një date për negociatat nga Tirana që ka të bëjë plotësisht me të drejtat reale të pakicës kombëtare bullgare. Prof. Terziu, jo më kot sjell për lexuesin një artikull të plotë dhe të pandryshuar nga origjinali, thuajse jashtë procedurës së referencimit, të shkruar nga Prof. Dr. Spasse Tashev, me qëllim mosndërhyrjen në disa pika që mund të quhen të plotëkuptueshme në një situatë të tillë. Është fjala për problemin e mosqetjes së „origjinës bullgare” për mjaft nga ata që aplikojnë për pasaportën e këtij shteti, në kushtet e sotme të komplikuar ekonomike, por që vetëm me këtë mundësi ata mund të lëvizin e të punësohen

(Vijon në faqen 11)

epigrame

"Më mirë të daltë syri se të të daltë boja!"

Njëherë një korb i bardhë u ly me bojë të zezë, duke u bërë korb i zi dhe iku nga tufa e korbave të bardhë, në tufën me korba të zinj.

Korbat e bardhë e vunë re se ishin një më pak, po nuk e bënë veten. Korbat e zinj e panë se ishin më shumë se më parë. Madje, ishte midis tyre një korb i çuditshëm, me një ngjyrë pak më ndryshe se ato, që lëshojë si i përfutur në të ngrënë dhe sillej ndryshe në krahasim me to.

Por, një ditë ra një shi i rrëmbyer dhe korbit të lyer me bojë ia hoqi bojën, duke e lënë të pullinxhur dhe shumë të bajatshëm. Korbat e zinj, të inatosur nisën ta çukisin me sqep duke e bërë përveç se të pullinxhur, edhe korb rjepç.

Mezi shpejtoi gjallë nga çukitjet e tyre. Shkoi dhe, duke menduar se i ishte hequr boja, u fut midis korbave të bardhë... Por korbat e bardhë e njohën dhe të inatosur me të për tradhëtinë që u kishte bërë, filluan ta çukisin edhe ato me sqep. Mezi shpëtoi dhe prej tyre. Mbeti as te tufa e korbave të bardhë, as të të zinj. Duke qenë i vetëm e zuri dhëpra, po edhe ajo e lëshoi se ky korb i bajatshëm, as i bardhë, as i zi, i dalë bojët kishte shije të keqe.

-Ah si e pësova, -tha korbi, -duke u lyer me bojë dhe duke më dalë boja!

Me këtë korbat e tjerë mësuan se nuk duhet të lyheshin me bojë për t'u dukur ndryshe seç janë dhe për të tradhëtuar grupin e tyre dhe as t'i nxir-



rnin bojën vetës. Që atëhere mbeti urim-mallkimi: "Më mire të daltë syri se të të daltë boja!"

Agim DEMIRI

Vepër shkencore me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore

(Vijon nga faqja 10)

diku në vendet europiane. Dhe konkluzioni i autorit: "Përgjigjia është mjaft kuptimplote, nëse nuk do të ishte kjo pasaportë, ata nuk do të kërkonin të ishin ndonjë lloj minoriteti". Siç shkrova në fillim, mjaft bindëse e bëjnë veprën e Terziut referencat nga arkivat britanike, të sintetizuar në pjesën e 5-të "Arkivat Britanike për Gollbordën".

TJETRI NË KËTË VEPËR TEJET DINJITOZE

Kjo vepër tejet dinjitoze, me interes të veçantë për lexuesin, mbyllet me pjesën e 6-të "Figurat dhe vlerat". Këtu autori na njeh me personalitetet emëndritur në histori të kësaj zone. Ndërsa evidenton origjinën shqiptare të Qemal Atatutkut, Terziu shkruan për Kapitenin e Parë Qazim Kasa - Drejtuesi ushtarak i Prishtinës, për "Piktorin e Popullit" Nexhmedin Zajmin, sidhe piktorët tjerë si, Bajram Mata, Tahir Zeneli, Duro Ibrahim etj. "...Lexoja kujtimet e Hasan Shahinajt, Dail Halilajt, Ibrahim Allës, Islam Ramës, Fatmir Selimit, Velo Cfarikut, Fidan Markut, Halil Hoxhës etj., dhe ndjehesha kryelartë, komentoja poezitë e dhjetra poetëve të Gollbordës dhe bëhesha letrar ndryshe, shikoja skulpturat e Hamza Halilit, Fitim Sulës, Bashkim Sadikut dhe përhumbesha në to, shikoja filmat dhe skenaret e Esat Musliut dhe s'kisha të ngopur, pastaj shkrimet e studimet e Hilmi Sadikut, Myqerem Tafaj, Ramazan Hoxhës, Besnik Ramës, Cefan Maznikut, Kujtim Boriçit, Mehmet Hasanit, Kristaq Trajës...", shkruan autori (fq.145). Prof Terziu vlerëson gjithashtu veprën e Doktor Arif Hasanit - "Qytetar Nderi i Dibrës", të këtij kirurgu duarartë që shpëtoi qindra jetë njerëzish.

KONKLuzioni I KONKLuzionit

Në pjesën e 7-të të librit janë konkluzionet e autorit. "Të dhënat e mbledhura në punën në terren gjatë viteve dëshmojnë se njerëzit e kësaj treve shprehin lidhjen e tyre të origjinës në mënyra të ndryshme. Disa e sqarojnë me një fjalë që përcaktohet sipas tyre me shprehjen "mije zborime bugarsko", dhe disa të

tjerë me një tjetër që bazohet tek "mije zborime nashincki, nashki". E para shkon ndoshta më larg në vitet kur sundonte dhe dominonte kultura dhe gjuha bullgare në rajon, duke lënë kështu kuptimin e fjalës së parë "ne flasim bullgarisht" dhe kuptimin e shprehjes së dytë "ne flasim gjuhën tonë, tonën". Dhe kështu kur mbetet zgjidhja nga toponimet kjo e fundit flet më së miri në këtë pikë, po aq sa e para. Pra, hipoteza jonë se toponimet ndikuan në këtë bashkësi në mënyrë të ngjashme në përvojën e identitetit të tij të pakicës është vërtetuar e gabuar. Për të forcuar këtë përfundim, komuniteti i Gollbordës që nuk kanë të njëjtën fe si bullgarët dhe maqedonasit duhet të ekzaminohet", shkruan prof. Terziu.

Ndërkohë ai sqaron lexuesin se puna kërkuese e këtij studimi është e një natyre skematike. Ai nuk pretendon se botimi është një përpjekje për të shtruar këtë temë, as nuk mendon "se kontrastet kulturore, sociale dhe historike të theksuara midis efektivitetit tjetër të madh kulturor të traditës Gollbordës janë të gjitha aq sa absolutja e dukurive kulturo-sociale është ekstremisht komplekse, dhe larmia e faktorëve që i përcaktojnë ato shkaktojnë që ato të ndryshojnë shumë gjatë zhvillimit të tyre, nganjëherë ndryshimet i bëjnë ato të duken plotësisht të kundërta.

Sidoqoftë, në thelb kontrastet që kam theksuar ekzistojnë. Idetë e përshkruara në këtë punë dhe faktet mbi të cilat ato bazohen mund të mbështeten nga një dokumentim i plotë dhe sistematik në shënimet e mbajtura nga rrëfimet, por duke pasur parasysh natyrën e punës kam preferuar të shtoj disa elementë plotësues. Ata merren me një temë themelore të tyre, por mbajnë disa aspekte themelore të pikës së parë të Gollbordës dhe do t'u interesojnë lexuesve që kujdesen të hyjnë më thellë në këtë temë". Parë në një këndvështrim të përgjithshëm, Prof. Dr. Fatmir Terziu trajton gjerësisht në këtë vepër madhore fenomenin shoqëror të transkulturimit dhe rëndësinë e tij në Gollbordë.

Të "ripërtypësh" qetësisht tezat e guximshme që hedh Fatmir Terziu në librin e vet mbi Gollbordën, këtë krahinë me tradita historike në vetë ekzistencën kombëtare shqiptare, duhet që librin

Vlerat e vërteta janë ato që kujtohen pas një shekulli


NGA AGIM DEMIRI

1. Pas çdo pyetje që i bëhet një të dituri thoshte: "Ah, ...ku di gjë unë më?!"...A thua vërtet nuk dinte asgjë? ...Ah, sa mirë dinte shumë gjera...
2. Për punën e mirë, që është bërë dhe bëhet nuk ka nevojë të flase kush...Ajo flet vetë.
3. Jo çdo punë matet me vlerë paraje!
4. Vlerat e vërteta janë ato që kujtohen pas një shekulli!
5. Burri i mirë e i urtë nuk ngutet në një zënie. Këtë nuk e bën për frikë, por për vlerë burrie.
6. Gruaja e mirë shikohet se si mban shtëpinë, burrin dhe fëmijën.
7. Do të shohësh vlerat e një katundi? Shikoi se si e ka urën, mullirin dhe rrugën e madhe!
8. Mjerimi më i madh për një skuadër dhe portier është kur ta bën golin lojtari yt!
9. Një lojtar bëmë i njohur edhe kur bën gol në portën e tij!
10. Më mirë të bëj një libër që ta lexojnë njëqind vetë se njëqind libra që nuk i lexon asnjë!
11. Vlera e një (= a disa librave) është kur vidhet, ose bëhet përpjekje për t'u vjedhur!
12. -Ku punon?
-Në teatër. Për katër vjet kam bërë rolin e servility. Duke thënë vetëm fjalët: "Mirëmëngjes shefi"...dhe kam shitur biletat. Për këtë u bëra artist.
13. Zanatçi nuk është ai që thotë që di të bëjë çdo gjë dhe rreh gjoksin për të, por ai që di të bëjë një a disa gjera, për të cilën thonë të tjerët për të!
14. Më mirë të bëj një kala si e Shkodrës se të bëj një fjalor!

to lexosh dhe rilexosh, sepse ka shumë kuptime mes rreshtave. Sikurse thamë më sipër pa marrë të mirëqënë faktin që Terziu i thotë të gjitha në këtë vepër studimore me tezat e një „doktorature universitare“, autori hap për diskutim akademik një çështje të mprehtë shqiptare: kush jemi dhe cila është pjesa jonë më ekzistenciale. Shqipëria duke qenë „kërthizë“ e gadishullit më të trazuar të kontinentit evropian, natyrisht ka shumë për të thënë dhe sqaruar duke konfirmuar devizën se autoktonia shqiptare jo vetëm që nuk diskutohet, por studime të mëtejshme do të kristalizojnë të vërtetën e „turbulluar nga koha“. Studimi i Fatmir Terziut nga Londra është një sfidë e hapur ndaj vetë Akademisë Shqiptare, që në monotoninë e vet përgjumëse ende nuk është kthyer në „gardën kombëtare“ të mbrojtjes me „zjarr akademik“ të të vërtetave gjithëshqiptare që shpesh mbulohen nga mashtime ulëritëse nga fqinjët tanë.

Autori meriton përgëzime jo vetëm për guximin hulumtues, por edhe për dritën që hedh mbi një krahinë të harruar dhe nënvlefësaur nga regjimet dhe administratat qëndore shqiptare. Në fund të fundit Shqipëria është një dhe mbetet një unison ballkanik me vitalitet që po testohet sërish në kohë lirie.

VOTO ⑨



Deputeti që ju dëgjon, ju respekton dhe ju mbron!

VOTO Nr. 4

**EDMOND
ISAKU**

